



Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

**ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
21 QERSHOR 2015**

Tiranë më 29 Qershor 2015

RAPORT I NDËRMJETËM MONITORIMI - IV 19 – 26 Qershor 2015

I. KONKLUZION PARAPRAK

Zhvillimi i zgjedhjeve periodike dhe në përputhje me parimet e një demokracie kushtetuese është një përpjekje që shoqëria shqiptare është angazhuar prej 25 vitesh. Përpjekje që në vazhdimësi ka vuajtur në arritjen e standarteve minimaliste ligjore.

Çdo proces zgjedhor deri më sot është përballur me rrezikun e kontestimit prej palës humbëse, dhe në këtë traditë, pala humbëse është vetvendosur si “çertifikuuesi” i vullnetit popullor.

Në fund të të gjitha garave elektorale, miratimi i garuesit humbës është shndërruar në standartin e vetëm që duhet sigurojë procesi. Kur në fakt, ai që informalisht quhet certifikim i procesit zgjedhor, është e domosdoshme të bëhet vetëm mbi bazën e kuadrit ligjor zgjedhor dhe prej trupës institucionale të ngarkuar në organizimin e zgjedhjeve.

Në këtë logjikë shtetformuese, Kodi Zgjedhor duhet të jetë rregulluesi i tërë organizimit dhe i përgatitjes së zgjedhjeve.

Ky kuadër parashikon veçmas rregullave, edhe institucionet ligjzbatuese (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve, Komisionet e Qendrave Votimit, Kolegji Zgjedhor).

Aspirata dhe detyrimi i marrë përsipër prej shoqërisë shqiptare, për zhvillimin e një procesi zgjedhor ligjor dhe legjitim, do të thotë zbatim besnik i tërë dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Në këtë periudhë të cilës i referohet ky raport i katërt, si edhe në tërë periudhën pararendëse të këtij raporti, e cila i përkiste përgatitjes së zgjedhjeve, fenomenet e 1) **moszbatimit të ligjit**, 2) **diskrecionalitetit në vendimmarrje dhe në gjykim**, 3) **keqadministrimit** dhe 4) **deformimit institucional**, janë shfaqur vazhdimisht prej tërë operatorëve zgjedhorë.

Këto fenomene të shfaqura në këtë proces zgjedhor që po mbyllet, janë arsyet përse janë cënuar ligjshmëria dhe proceduraliteti i procesit. Kjo për arsyet që vijojnë:

1) Çdo normë, rregull, dispozitë, ligj apo proces ligjor, ka pjesë të veten pashmangshmërisht afate dhe shtrirje kohore.

Në ngritjen e qendrave të votimit, në caktimin e vendndodhjeve të qendrave të votimit dhe vendeve të numërimit të votave, përgatitjen dhe hartimin e listave të zgjedhësve, tërë afatet ligjore u tejkaloan aq sa praktikisht zhbënë parashikimet ligjore.

2) Kodi Zgjedhor, secilit institucion dhe çdo funksionari në këto institucione i parashikon të drejtat dhe detyrat që i ngarkohen.

Në rastin e personave që vuanin heqjen e lirisë në institucione penitenciare, të cilët për faj të administratës shtetërore nuk u bënë pjesë e listave të zgjedhësve brenda afatit ligjor, u përdor një artific ligjor i gabuar për t'ia mundësuar atyre të drejtën e votimit.

Përpos vullnetit pozitiv, të prezumuar, pasi nuk zbatohet dhe anashkalohet çdo procedurë dhe regullim që kuadri ligjor parashikon, nuk mundet që vetëm në fazën finale të procesit t'i kushtohet vëmendje garantimit të një të drejte duke shkelur sërish ligjin.

3) Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit, janë trupat kolegjiale që përpos të tjerave, iu besohet gati tërësisht mbarëvajtja e ditës së zgjedhjeve.

Këto komisione të ngritura ad-hoc, me një formulë mbi bazën e balancimit politik, janë tepër të atakueshëm prej presionit politik.

Garancia më e fortë që këto komisione të funksionojnë ashtu si e kërkon kuadri ligjor është trajnimi që duhet kryer prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rastin më të keq, ata komisionerë duhet të jenë të vetëdijshëm kur veprojnë në përputhje apo në kundërshtim me ligjin.

Lirim-emërimet e ekzagjeruara në numër dhe në kohë të komisionerëve të KZAZ-ve dhe vonesat në ngritjen e GNV-ve dhe KQV-ve, u bënë shkak për nivelin e ulët të vërejtur në përgatitjen dhe formimin e atyre komisionerëve për detyrat e tyre.

4) Përpos problematikave që krijuan, tre vërejtjet e sipërpërmendura, në një shoqëri në tranzicion që rreket të ndërtojë një shtet ligjor dhe të së drejtës, sjellin një dëm akoma më të rëndë në planin afatgjatë, që është deformimi i institucioneve.

Në historikun zgjedhor nëse kalohet nga një precedent negativ në tjetrin, arritja e standarteve në vijueshmëri do bëhet akoma më e vështirë.

Përballë sfidave në organizim që sjell normalisht çdo proces, problemi më madh do jetë në vazhdim zhbërja e traditës së keqfunksionimit dhe të shkeljes së ligjit prej të gjithë institucioneve dhe funksionarëve.

Cënimi i procesit ligjor, ndër të tjera përbën cënim të vullnetit të legjislatorit si autori i hartimit të kuadrit ligjor.

Një proces zgjedhor ka për qëllim të vetin një aspiratë më të lartë, që është shfaqja e vullnetit dhe zbatimi i verdiktit të sovranit.

Ecuria e qetë e ditës së zgjedhjeve, shtrirja kohore jo e ekzagjeruar e procesit të numërimit dhe atmosfera politike deri më tani gjithëpranuese, deri në këtë moment duket se po i japin këtij procesi zgjedhor cilësinë e mos cënimit të vullnetit të votuesve.

Duke i sjellë në vëmendje tërë problematikat e përmendura prej Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë në raportet e mëparshme dhe këtë në fjalë, respektimi i vullnetit popullor deri në fund të procesit, do i japë legjitimitet këtyre zgjedhje, ndonëse ligjërisht të cënuara.

Të gjendur në etapën finalizuese të procesit, që janë ankimimet dhe apelimet, vlen t'i tërhiqet vëmendja operatorëve, pjesë e drejtësisë zgjedhore, që të jenë maksimalisht të angazhuar në zbatimin më të saktë të kuadrit ligjor.

Këta operatorë, duhet të tregohen të përgjegjshëm dhe të shmangin problematikat e shfaqura deri më tani si inkoherenca, diskrecionaliteti në vendimmarrje, dhe mos zbatimimi i ligjit.

Transparenca është një element formal, por që përcakton jashtëzakonisht përmbajtjen e jetës institucionale. Një vlerë që në procesin zgjedhor përthyeret në dy detyrime ligjore për institucionet; e drejta e informimit dhe e drejta e vëzhgimit.

Ndonëse përgjatë punës së Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë këto dy të drejta janë mohuar disa herë, si në dhënien e informacioneve të kërkuara si dhe në mohimin e prezencës gjatë procesit zgjedhor, ato duhen mbajtur parasysh rigorozisht për atë sa këto zgjedhje duan të finalizohen, por sidomos në proceset që do vijojnë.

Institucioni për të cilin procesi zgjedhor ende nuk ka mbaruar dhe nuk duhet të vlerësohet si i mbyllur deri në finalizimin e hetimeve, është Prokuroria e Përgjithshme (dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore).

Janë ngritur shumë akuza prej disa subjekteve zgjedhore dhe janë sjellë indicie të shumta edhe prej mediave për krime elektorale të konsumuara në këtë proces zgjedhor.

Më e rënda ndër ato ka qenë krimi i blerjes së votës.

Akuzat dhe indiciet e përfolura, duhet të jetë në objektivat më prioritarë të institucionit të hetimit.

Klasa politike në vazhden e maturisë së treguar duhet të angazhohet fort për të krijuar një klimë mbështetëse ndaj organeve përkatëse për të adresuar, hetuar dhe çuar deri në fund, nën një transparence të plotë, çdo çështje lidhur me procesin zgjedhor pa e lënë atë në hije, pavarësisht certifikimit të rezultateve, apo të sjelljes në vëmendje të prioritetive të tjera më madhore apo ngjarje të ditës, duke siguruar adresimin e duhur ligjor dhe testimin deri në fund të institucioneve dhe të sistemit të drejtësisë zgjedhore.

II. GJETJE

A. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

A.1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në këtë periudhë vëzhgimi, fillon me Vendimin nr. 680 (19.05.2015) dhe në vazhdim.

Proporcionalisht vendimmarrja e KQZ-së ka qenë së shumti 7-0, por vazhdohet që në çështjet e shumë të diskutuara të votohet në bllok 4-3, ku në përgjithësi tre Komisionerët në "minorancë" janë znj. Shtjefni, z. Osmanaj dhe z. Zguri.

Tematika e akteve të kësaj periudhe kategorizohet më së shumti në katër lloje si më poshtë:

- miratimi i vëzhguesve të organizmave ndërkombëtare dhe i mediave;
- lirimi dhe emërimi i disa anëtarëve të KZAZ-ve;
- urdhërime për nisje të procesit të numërimit në KZAZ-të; dhe
- raporti i katërt i Bordit të Monitorimit të Medias.

Vendimmarrja përpara ditës së zgjedhjeve

Në vendimmarrjen e kësaj periudhe u vunë re këto problematika:

1. Inkoherenca në vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë e ka ngritur edhe më parë shqetësimin e inkoherencës në vendimmarrjen e KQZ-së.

Këtë shqetësim e kanë artikuluar edhe vetë anëtarët e këtij Komisioni së bashku me përfaqësuesit e subjekteve politike gjatë seancave në këtë periudhë vëzhgimi.

Megjithë pranimin e vetë anëtarëve, ky fenomen ka vazhduar në vendimmarrjen e KQZ-së.

Ajo që e bën më shqetësuese është ndërrimi i qendrimeve minorancë-mazhorancë brenda KQZ-së, të cilat kanë përkuar edhe me qendrimet e dy përfaqësuesve të dy forcave politike më të mëdha pranë KQZ-së, përkatësisht të Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD).

Inkoherenca dhe ndërrimi i qendrimeve prej Komisionerëve u vu re në dy raste.

I pari, ka të bëjë me diskutimet për transferimin e listave të zgjedhësve në Bashkinë e Durrësit, i cili ishte pikë e rendit të ditës në seancën e datës 19.06.2015.

Në rastin *e dytë*, janë diskutimet për ngritjen e Qendrave të Votimit të Posaçme (QVP) në institucionet penitenciare, gjatë seancës të datës 20.05.2015.

Në këto mbledhje, të tërë pjesëmarrësit në argumentimet e tyre, përpara momentit të vendimmarrjes, binin dakort që ishin përballë një situatë jashtë kuadrit ligjor.

Në rastin e parë, përfaqësuesi i PD-së kërkonte ç' regjistrimin e zgjedhësve nga listat për Bashkinë e Durrësit, me pretendimin se ishin transferuar në shkelje me ligjin.

Në këtë rast “shumica” prej katër anëtarësh, mbronte qendrimin se KQZ-ja nuk mund t’i kapërcente tagrat që i jepte Kodi Zgjedhor.

Ndërsa “pakica” e tre anëtarëve argumentonte se ndonëse jashtë tagrave KQZ-ja kishte detyrimin të mbronte parimin e një garimi të ndershëm dhe të barabartë.

Situata u përmbys në rastin e dytë ku u diskutua për ngritjen e QVP-ve në institucionet penitenciare.

Në këtë rast “shumica” e katër anëtarëve mbrojti qendrimin se ndonëse ishin në kundërshtim me afatet dhe dispozitat e ligjit zgjedhor, duhej të merrnin masa për personat e burgosur që nuk ishin përfshirë në listat e zgjedhësve.

Sipas tyre, e drejta e votimit e këtyre personave prevalonte përballë mosparashikimit ligjor.

2. Administrimi jashtë kuadrit ligjor dhe pa proceduralitet

Mospërfshirja në listat e zgjedhësve të personave të burgosur në institucione penitencare, e vuri disa herë në tension artificial jetën institucionale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vështirësitë e krijuara e detyruan KQZ-në të kishte vendimmarrje për këtë çështje deri pak orë përpara nisjes së procesit të votimit.

Në seancën e datës 21.06.2015 (ora 00:30), me Vendimin nr. 723, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kërkoi 17 KZAZ-ve të siguronin nga KQV-të e ZAZ-ve përkatëse që administronin një numër fletësh votimi dhe më pas t’ua shpërndanin ato 17 KQV-ve sipas nevojave dhe numrit të përcaktuar në vendimin e KQZ-së¹, në mënyrë që këto 17 KQV të

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 723, datë 21.06.2016, “Për sigurimin e fletëve të votimit shtesë për disa qendra votimi të posaçme”. Sipas tij: “1. Autorizohet KZAZ-ja Nr.64, qarku Berat, që me vendim të marr 18 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr. 3278. 2. Autorizohet KZAZ-ja Nr.16, qarku Dibër, që me vendim të marr 6 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.09382. 3. Autorizohet KZAZ-ja Nr.22, qarku Durrës, që me vendim të marr 282 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.14222. 4. Autorizohet KZAZ-ja Nr.20, qarku Durrës, që me vendim të marr 476 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë 348 fletë KQV-së nr. 12921 dhe 128 fletë KQV-së nr.1274. 5. Autorizohet KZAZ-ja Nr.44, qarku Elbasan, që me vendim të marr 400 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.22732. 6. Autorizohet KZAZ-ja Nr.45, qarku Elbasan, që me vendim të marr 80 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.25651. 7. Autorizohet KZAZ-ja Nr.77, qarku Gjirokastër, që me vendim të marr 2 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.43831. 8. Autorizohet KZAZ-ja Nr.71, qarku Korçë, që me vendim të marr 46 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.37071. 9. Autorizohet KZAZ-ja Nr.11, qarku Kukës, që me vendim të marr 8 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.06361. 10. Autorizohet KZAZ-ja Nr.13, qarku Lezhë, që me vendim të marr 365 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.07481. 11. Autorizohet KZAZ-ja Nr.31, qarku Tiranë, që me vendim të marr 9 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.1690. 12. Autorizohet KZAZ-ja Nr.39, qarku Tiranë, që me vendim të marr 28 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.1967. 13. Autorizohet KZAZ-ja Nr.29, qarku Tiranë, që me vendim të marr 20 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.2113. 14. Autorizohet KZAZ-ja Nr.39, qarku Tiranë, që me vendim të marr 28 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.1967. 15. Autorizohet KZAZ-ja Nr.43, qarku Tiranë, që me vendim të marr 420 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.22242. 16. Autorizohet KZAZ-ja Nr.83, qarku Vlorë, që me vendim të marr 29 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.4451. 17. Autorizohet KZAZ-ja Nr.88, qarku Vlorë, që me vendim të marr 3 fletë votimi nga QV-të e ZAZ-së që administron dhe t’i dorëzojë KQV-së nr.4678.”

mund t'u jepnin të drejtën e votimit edhe të dënuarve për të cilat ishte marrë tashmë vendimi i gjykatës.

Për shkak të mungesës së kohës fizike u vendos që proceduraliteti sesi KZAZ-të do t'i siguronin prej KQV-ve fletët e votimit të nevojshme dhe sesi do t'ia dorëzonin KQV-ve që iu nevojiteshin, të lihej në diskrecionalitetin e këtyre Komisioneve.

3. Ndryshimi i vendodhjes së Qendrave të Votimit dhe i Vendeve të Numërimit të Votave

Ndryshimi i Qendrave të Votimit dhe i Vendeve të Numërimit të Votave e ka shoqëruar procesin përgatitor të zgjedhjeve jo vetëm përtej çdo afati ligjor, por dhe deri në orët e fundit para nisjes së procesit të votimit.

- Vendimi nr. 721, datë 20.05.2015, “Për dhënien e autorizimit për ndryshimin dhe caktimin e vendndodhjes së qendës së votimit nr. 1264, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 21 qershor 2015.”² (Ora 23:00)

- Vendimi nr. 717, datë 20.05.2015, “Për dhënien e autorizimit për ndryshimin dhe caktimin e vendndodhjes të qendrave të votimit nr 3304 dhe 33041, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 21 qershor 2015.” (Ora 19:00)

- Vendimi nr. 709, datë 20.05.2015, “Për një ndryshim në vendimin Nr. 423, datë 15.05.2015, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 8, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”.” (Ora 12:00)

Vendimmarrja gjatë ditës së zgjedhjeve dhe përgjatë procesit të numërimit

Gjatë ditës së zgjedhjeve dhe gjatë ditëve që zgjati procesi i numërimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve së bashku me administratën e tij kanë qenë në mbështetje dhe monitorim të vazhdueshëm të Komisioneve të nivelit të dytë dhe të tretë, përkatësisht të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (përfshirë edhe Grupet e Numërimit të Votave) dhe të Komisioneve të Qendrave të Votimit.

Ashtu siç edhe është shprehur përgjatë seancave prej vetë Anëtarëve të Komisionit, në këtë pikë të procesit sjellja e Komisionerëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve ka qenë nën drejtimin e subjekteve politike.

Kjo vihej re veçanërisht në rastet e problematikave të shfaqura, ku evidentohet qartë se më të mirëinformuar ishin përfaqësuesit politikë sesa administrata e KQZ-së.

Nga sa u pa nga problematikat e diskutuara në seancat e zhvilluara, dhe siç u pranua dhe nga administrata, komisionerët e KZAZ-ve dhe sidomos ato të KQV-ve kanë qenë të patrajnuar ose të keqinformuar për detyrat e tyre dhe për procesin zgjedhor.

² Në ZAZ nr. 20, QV nr. 1264, Fshati Bruz Zallë, Bashkia Krujë.

A.2. KOMISIONET ZONALE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Komisionet Zonale të Adminsitrimt Zgjedhor (KZAZ) janë komisionet e nivelit të dytë, përgjegjëse për administrimin e procesit zgjedhor në 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor në të cilat është ndarë vendi. Roli i këtyre strukturave në mbarëvajtjen e procesit është thelbësor, veçanërisht përgjatë proceseve zgjedhore për organe të qeverisjes vendore duke qenë se kanë kompetenca të shtuara në këto raste, të tilla si regjistrimi i kandidatëve dhe shpallja e rezultateve të zgjedhjeve për bashkitë që mbulohen nga 1 KZAZ e vetme.

Performanca e KZAZ-ve ditën përpara Ditës së Votimit

Një nga kompetencat kryesore të KZAZ-ve në ditën përpara ditës së votimit është shpërndarja e materialeve zgjedhore për të gjitha Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) nën juridiksionin e vet.

Sipas Kodit Zgjedhor: “KZAZ-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj³.”

Duke qenë se votimi hapet në orën 07:00, KZAZ-të do të duhet ta kishin përfunduar procesin e shpërndarjes së materialeve zgjedhore për KQV-të deri në orën 16:00 të ditës së shtunë, datë 20 qershor 2015.

Sipas raportimeve të vëzhguesve të KVV-së, në një numër të konsiderueshëm të ZAZ-ve materialet janë shpërndarë pas orës 16:00 të ditës së shtunë⁴, duke bërë që në disa ZAZ të vonohet hapja e QV-ve.

Një nga problemet më të mprehta që mund të përmendet për performancën e KZAZ-ve është dështimi për të kontrolluar bazën materiale të marrë në dorëzim prej KQZ-së, çka solli që në tre Bashki të votohet me fletë votimi të printuara gabim⁵.

³ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012). Neni 100 “Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV”, pika 1. <http://www2.cec.org.al/sq-al/kodi-zgjedhor>.

⁴ Si p.sh. në KZAZ nr. 42, Bashkia Kavajë; në KZAZ nr. 14, Bashkia Mirditë, shpërndarja ka nisur rreth orës 03:00 të mëngjesit të ditës së votimit pasi janë ndërruar komisionerët; në KZAZ nr. 74, Bashkia Përmet, shpërndarja është kryer më vonë pasi anëtarët e komisioneve janë paraqitur me vonesë në KZAZ; në KZAZ nr. 41, Bashkia Tiranë; në KZAZ nr. 78, Bashkia Gjirokastrë, shpërndarja e materialeve ka nisur pas orës 17:30 për të gjitha QV-të pasi janë ndryshuar komisionerët në disa QV dhe anëtarët e KZAZ-së janë marrë me zëvendësimin para se të fillojnë me shpërndarjen e materialeve; në KZAZ nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, Bashkia Shkodër (në KZAZ nr. 4 shpërndarja e materialeve ka përfunduar pas orës 2:30 të mëngjesit të ditës së zgjedhjeve dhe në KZAZ nr. 2 shpërndarja ka nisur në orën 19.30 të ditës së shtunë dhe përfundoi në mëngjesin e së dielës rreth orës 06:45, pasi partitë politike nuk kishin përfunduar zgjedhjen e komisionereve për QV); në KZAZ nr. 71, Bashkia Korçë; në KZAZ nr. 89, Bashkia Finiq, disa QV janë hapur me vonesë pasi kishin mungesa në bazën materiale, ndërkohë që anëtarët e KZAZ-ve pretendonin se i kishin nisur ato të plota; në KZAZ nr. 82, nr. 83 dhe nr. 84, Bashkia Vlorë; në KZAZ nr. 86, Bashkia Himarë; në KZAZ nr. 1, Bashkia Malësi e Madhe; në KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës; në KZAZ nr. 12, Bashkia Lezhë; në KZAZ nr. 18, Bashkia Bulqizë; në KZAZ nr. 19, Bashkia Dibër; në KZAZ nr. 28, Bashkia Kamëz; në KZAZ nr. 67, Bashkia Pogradec; në KZAZ nr. 68, Bashkia Maliq; në KZAZ nr. 73, Bashkia Kolonjë; në KZAZ nr. 75, Bashkia Këlcyrë; në KZAZ nr. 76, Bashkia Memaliaj; në KZAZ nr. 77, Bashkia Tepelenë; në KZAZ nr. 79, Bashkia Libohovë; në KZAZ nr. 81, Bashkia Vlorë; në KZAZ nr. 85, Bashkia Selenicë; në KZAZ nr. 87, Bashkia Delvinë; në KZAZ nr. 88, Bashkia Sarandë; në KZAZ nr. 9, Bashkia Tropojë; në KZAZ nr. 90, Bashkia Konispol; në KZAZ nr. 26, Bashkia Vorë; në KZAZ nr. 22 dhe nr. 23, Bashkia Durrës; etj.

⁵ Bashkia Tepelenë, Bashkia Roskovec dhe Bashkia Devoll.

Pavarësisht se përgjegjësia kryesore për këtë gabim, i cili potencialisht mund të shpjerë në përsëritjen e zgjedhjeve në këto bashki, bie mbi administratën e KQZ-së e cila duhet të kishte kontrolluar saktësinë e printimit të fletëve të votimit që në momentin e shtypjes së tyre, edhe anëtarët e KZAZ-ve kanë jo pak përgjegjësi lidhur me këtë problematikë.

Performanca e KZAZ-ve ditën e votimit

Gjatë ditës së votimi KZAZ-ja mbikqyr procesin zgjedhor në QV-të nën juridiksionin e vet dhe është në gadishmëri për çdo problematikë që mund të shfaqet për t'iu dhënë udhëzime e duhura KQV-ve dhe zgjidhur këto problematika.

Është vënë re se disa KZAZ gjatë ditës së votimit nuk kanë qenë në detyrë që prej orës shtatë të mëngjesit, pavarësisht se ndërkohë kishte nisur procesi i votimit⁶, duke lenë pa mbikqyrur ecurinë e hapjes së QV-ve.

Përsa i përket hapjes së QV-ve, në shumë KZAZ ka mbërritur informacion për QV të hapura me vonesë apo që kishin mungesa në bazën materiale⁷.

Ndërkohë, vlen të përmendet se në mjaft KZAZ informacioni nga qendrat e votimit vinte i mangët⁸.

Ndërimi i Komisionerëve të QV-ve në momentet e fundit dhe mungesa e trajnimit të tyre ishte një problem i evidentuar në shumë ZAZ dhe që KVV e ka ngritur edhe në raportet e mëparshme.

Kodi Zgjedhor u njeh partive politike tagrin për të ndryshuar Komisionerët e ZAZ-ve pa asnjë limit kohor dhe shumica e partive politike e përdorën këtë të drejtë, madje duke abuzuar me të⁹.

⁶ KZAZ-ja nr. 78, Bashkia Gjirokastër është hapur në orën 8:00 të ditës së zgjedhjeve; në KZAZ nr. 1, Bashkia Malësi e Madhe, në momentin e hapjes së saj, tre komisionerët e emëruar nga PD-ja nuk ishin prezentë; KZAZ-ja nr. 52 Bashkia Librazhd është hapur vetëm me pesë anëtarë ditën e votimit. Anëtarët e tjerë kanë ardhur me vonesë pasi kanë qenë të lodhur nga puna deri në orët e vona një natë më parë; ZAZ-ja nr. 78 u hap në 7:39 pasi komisionerët erdhën me vonesë; në ZAZ 68, Bashkia Maliq;

⁷ Si KZAZ nr. 88, Bashkia Sarandë; KZAZ nr. 80, Bashkia Dropull; KZAZ nr. 52, Bashkia Librazhd; KZAZ nr. 3, Bashkia Shkodër: në QV nr. 0281 në orën 7.00 nuk kishte asnjë komisioner. Kjo QV u hap në orën 8.30; KZAZ nr. 40, Bashkia Tiranë; në KZAZ nr. 78, Bashkia Gjirokaster, QV nr. 4226 u hap në orën 8:30 sepse klasa e shkolles ku ndodhej QV-ja nuk kishte dritë të mjaftueshme dhe shiu vinte nga dritaret; në KZAZ nr. 72, Bashkia Korçë, ka patur një numër QV-sh të hapura me rreth 15 minuta vonesë, por ajo çka është shqetësuese është se anëtarët e KZAZ e konsiderojnë normal këtë fakt; në KZAZ nr. 71, Bashkia Korçë, QV nr. 3702 u hap në orën 8:10 dhe QV nr. 3729 në 8:00. Në këto dy raste pati vonesa pasi kapaku i kutise së materialeve zgjedhore ishte shkëmbyer me atë të kutisë së votimit. Po ashtu rezultoi se QV nr. 3827/1 u hap në orën 8⁵⁵ dhe QV nr. 3833 u hap në orën 9³⁰

⁸ Si p.sh. në KZAZ nr. 88 ku në orën 8:00 të ditës së votimit KZAZ-ja nuk kishte ende informacion të plotë mbi numrin e QV-ve që ishin hapur, apo të atyre që nuk ishin hapur.

⁹ Në KZAZ nr. 80, Bashkia Dropull, raportohet se thujse asnjë Komisioner nuk ka qenë i trajnuar, në të gjithë zonën, me përjashtim të Komisionerëve që kishin eksperiencë pasi ishin trajnuar për procese të mëparshme zgjedhore. Për më tepër, tri anëtarët e propozuar nga Partia Socialiste në këtë ZAZ janë ndryshuar me një vendim të KQZ-së të orës 20:00 të dt. 20 qershor, vetëm 11 orë përpara nisjes së votimit, pas një kërkese të subjektit që i kishte propozuar pasi nuk ishin banorë të Bashkisë Dropull, siç e kërkon Kodi Zgjedhor (Neni 31, pika c. Sanksionon që anëtari i KZAZ-së duhet të jetë me banim brenda zonës zgjedhore).

Ndryshimi i tyre dhe mungesa e trajnimit për anëtarët zëvendësues solli që gjatë ditës së zgjedhjeve dy prej tre komisionerëve të liruar të ishin prezentë herë pas here në KZAZ në mënyrë që të asistonin komisionerët e emëruar një natë më parë, ndërkohë që nuk kishin tagër për të qenë aty.

U evidentuan edhe raste të ndërrimit të Komisionerëve të QV-ve në ditën e votimit pasi rezultuan të ishin njëkohësisht edhe kandidatë për këshillin bashkiak¹⁰ apo për të tjera shkëlqe të kërkesave të Kodit Zgjedhor¹¹, apo edhe rasti i bashkisë Vlorë në të cilën në momentin e fillimit të votimit kanë munguar komisionerët e Partisë Republikane në thuajse të gjitha QV-të¹².

Procesi ka nisur me gjashtë Komisionerë ndërkohë që gjatë ditës një pjesë e tyre janë plotësuar, por sërish, në mbyllje të votimit, rreth gjysma e KQV-ve e administroi procesin e votimit vetëm me gjashtë anëtarë.

Gjatë ditës së votimit pati raste të ndërprerjes së procesit të votimit për arsye të ndryshme. Përgjithësisht, në këto raste KZAZ-të respektive vepruan me shpejtësi dhe e menaxhuan mirë procesin¹³.

Ndërkohë pati së paku dy raste në të cilat KZAZ-të u mbyllën gjatë ditës së votimit¹⁴.

Në një numër KZAZ-sh mbërritën informacione për zgjedhës që nuk mundën të votojnë, për arsye të ndryshme si: mungesa e dokumenteve të duhura¹⁵, nuk gjenin emrin në listë¹⁶ apo për shkak të ndryshimit të mbiemrit në dokumentin identifikues¹⁷.

¹⁰ Në KZAZ nr. 78, Bashkia Gjirokastrë, në QV nr. 4319, dy anëtarë të KQV-së rezultuan kandidatë për këshillin bashkiak të Gjirokastrës dhe janë ndërruar me kërkesë të komisionerëve të PS. Ndërkohë që në QV nr. 4313, dy anëtarë të KQV-së nga PD ishin kandidatë për Këshillin Bashkiak dhe janë ndërruar me kërkesë të komisionerëve të LSI.

¹¹ Në ZAZ nr. 90, Bashkia Konispol, u ndërrua komisionerët e PR në QV nr. 4731/1 sepse u largua nga QV dhe në QV nr. 4732/2 sepse nuk ishte paraqitur në detyrë.

Ndërkohë që në QV nr. 4731/2 komisioneri i PD u ndryshua nga KZAZ sepse u bënte presion votuesve; Në KZAZ nr. 3 Bashkia Shokdër, QV nr. 0243, sekretari i komisionit është larguar nga QV-ja në orën 18:30 dhe ka marrë dhe vulën me vetë. Është zëvendësuar dhe ka kthyer vulën.

¹² Komisionerët e kësaj partie kanë munguar në detyrë në masë edhe në ZAZ të tjera, si në QV-të e ZAZ nr. 21, Bashkia Durrës apo në ZAZ nr. 88, Bashkia Sarandë, ku janë zëvendësuar kryesisht nga KZAZ-ja.

¹³ Në ZAZ nr. 14, Bashkia Mirditë: në QV nr. 0822 procesi i votimit u ndërpre nga ora 12.00-12.15, për arsye të mosmarrëveshjeve midis Komisionerëve lidhur me dyshime për votim familjar. Në QV nr. 0032 procesi u ndërpre për rreth 15 minuta në orën 10:00 sepse është dëmtuar kutia e votimit. KZAZ-ja vendosi rinisjen e procesit pasi u konkluduar se kutia ishte dëmtuar pa qëllim; Në KZAZ nr. 1, Bashkia Malësi e Madhe: në orën 12:00 u ndërpre procesi i votimit në QV nr. 0002 për arsye të konfliktit mes komisionerëve për shkak të një votuesi që donte të votonte për familjarët e vet. Kryetari i QV-së nuk e ka lejuar, ndërkohë që disa anëtarë kanë thënë se nuk ka asnjë problem. Kryetari ka bllokuar procesin dhe ka kërkuar ndërhyrjen e KZAZ-së. Vetë Kryetari i KZAZ-së shkoi në këtë QV për të parë situatën dhe procesi rinisi rreth orës 15:30; Në KZAZ nr. 19, Bashkia Dibër: në QV nr. 1224 u ndërpre votimi për rreth 20 minuta sepse një votues deklaroi votën publikisht; Në KZAZ nr. 14, Bashkia Mirditë: në QV nr. 0836 u ndërpre votimi për 15 min për shkak se një flete votimi kishte defekt nga prodhimi çka solli edhe një debat midis komisionerëve të PS dhe PD; Në KZAZ nr. 40, Bashkia Tiranë: në QV nr. 199 Komisionerja e PD ka ndërprerë procesin 5-6 herë gjatë ditës nga 10 min me pretendimin se nuk janë prezentë vëzhgues të subjektit zgjedhor që ajo përfaqësonte. Procesi ka rinisur me vendim - urdhër të KZAZ-së; Në KZAZ nr. 78, Bashkia Gjirokastrë. QV nr. 4242 bllokoi procesin nga ora 9:30-10:00 sepse një person shoqëruar kërkonte të shoqëronte më shumë se një person me aftësi të kufizuara apo të tjerë zgjedhës që kërkonin asistencë për të votuar. KZAZ-ja mbajti një procesvebal për rastin dhe iu komunikoi komisionerëve të QV-së çfarë parashikon Kodi Zgjedhor në këto raste. Në KZAZ nr. 77, Bashkia Tepelene: në orën 08:37 u pezullua votimi nga KZAZ-ja në të gjitha qendrat e votimit pasi u konstatua gabim në printimin e fletës së votimit, ku numrat rendorë të kandidatit për kryetar bashkie ishin 1,2,2 dhe jo 1,2,3. Procesi rinisi në orën 10:50 pas një vendimi të KQZ-së; Në KZAZ nr. 70, Bashkia Devoll: u pezullua votimi pasi në fletën e votimit për këshillin bashkiak të dyja koalicionet ishin shënuar APPD. KZAZ-ja vendosi për vazhdimin e votimit pas ndërhyrjes së KQZ-së; Në KZAZ nr. 73, Bashkia Kolonje: në QV nr. 4024 u bllokua për rreth 10 minuta procesi i votimit pasi në afërsi të QV-së kishte grumbullime të militantëve të partive politike. U njoftua KZAZ-ja, e cila vendosi të vazhdohej procesi i votimit; Në KZAZ nr. 22 Bashkia Durrës dhe në KZAZ nr. 45 Bashkia Belsh, në QV-të e burgut të Durrësit dhe të Kosovës u ndërpre votimi sepse mungonin fletët e votimit. Procesi rifilloi pasi KZAZ-ja çoi fletë votimi shtesë të marra nga të tjera QV.

¹⁴ KZAZ nr. 78 Bashkia Gjirokastrë dhe KZAZ nr. 2 Bashkia Shkodër u mbyllën gjatë ditës së votimit dhe të gjithë komisionerët u larguan për pushim.

Gjatë ditës së votimit u evidentuan edhe raste të tjera shkeljesh, ku ndër më kryesoret përmendim:

- Në ZAZ nr. 68, Bashkia Maliq, në QV nr. 3830/1, disa votues me aftësi të kufizuara nuk u lejuan nga KQV-ja të votonin të shoqëruar nga shoqëruesi që ata kishin me vete, me pretekstin se ata nuk ishin me aftësi të kufizuara.

- Në disa ZAZ pati pretendime për blerje vote apo presion ndaj zgjedhësve. Në ZAZ nr. 26, Bashkia Vorë gjatë ditës së zgjedhjeve në hyrje të QV-ve pati grupime personash, për të cilët është pretenduar se penguan votuesit të shkojnë për të votuar, duke i akuzuar se nuk janë banorë të Vorës dhe se janë shtuar në listë në mënyrë fiktive¹⁵.

Rasti u bë publik në media dhe shumë vëzhgues vendorë e ndërkombëtarë u fokusuan në Vorë. KVV dërgoi një ekip vëzhguesish për të vërejtur situatën nga afër rreth orës 12:00 dhe vëzhguesit vunë re grumbullime individësh përpara qendrave të votimit me numër 1550, 1550/1, 1556, 1556/1, 1557 dhe 1557/1.

Personat e grumbulluar nuk kishin shenja dalluese të partive politike dhe nuk kryenin veprime haptas kërcënuese, por prezenca e tyre në grupe përpara Qendrave të Votimit dhe qëndrimi i tyre i vazhdueshëm aty krijonte tension dhe përbënte potencialisht kërcënim për zgjedhësit.

- Në ZAZ nr. 64, Bashkia Berat, në QV nr. 3308 poshtë dhomës së fshehtë u gjetën tre fletë votimi (2 për kryetar dhe 1 për këshill) të cilat u konsideruan të parregullta nga komisioni i QV-së, por mbetet e paqartë se si këto fletë votimi kishin mbërritur aty.

- Në ZAZ nr. 3, Bashkia Shkodër, në QV nr. 0299 Komisionerët gjetën fletë votimi poshtë kutisë së votimit rreth orës 18:00. Sërish nuk ishte e qartë se si kjo gjë ndodhi. Ndërkohë, në po këtë QV rreth orës 16:30, një votues, pasi morri fletën e votimit dhe hyri në dhomën e fshehtë, vrapoi jashtë QV-së me gjithë fletën e votimit. Fleta e votimit bosh e nxjerrë nga QV-ja është një fenomen shumë shqetësues pasi krijon mundësinë që në atë QV të ketë deformim të rezultatit si pasojë e blerjes së votës.

- Në disa KZAZ u raportuan edhe raste të fotografimit të votës¹⁹

¹⁵ Në ZAZ nr. 42, Bashkia Kavajë, vetëm në QV nr. 2169 u regjistruan rreth 30 raste ndalimi të votuesve për të votuar pasi nuk kishin me vete dokumentat e duhur. Në po të njëjtën KZAZ pati informacion për ndërprerje të procesit të votimit pasi ka patur zgjedhës që janë paraqitur për të votuar me patente apo pasaportë që i kishte kaluar afati. Asnjë nga këto raste nuk është lejuar të votojë; Në KZAZ nr. 38, Bashkia Tiranë, janë paraqitur dy persona me karta identiteti të dëmtuara që pretendonin të votonin me këto karta. Ka patur një debat mes kryetarit të KZAZ-së dhe një anëtarit të saj të forcës së kundërt politike, pasi anëtarit kërkonte që këta persona të lejoheshin të votonin ndërsa kryetari nuk pranonte.

¹⁶ Si në KZAZ nr. 42, Bashkia Kavajë; në KZAZ nr. 5, Bashkia Shkodër; në KZAZ nr. 60, Bashkia Roskovec; në KZAZ nr. 19, Bashkia Dibër.

¹⁷ Si në KZAZ nr. 26, Bashkia Vorë; në ZAZ nr. 12, Bashkia Lezhë; në KZAZ nr. 52, Bashkia Librazhd; në KZAZ nr. 72, Bashkia Korçë; në KZAZ nr. 88, Bashkia Sarandë.

¹⁸ Duhet theksuar se subjekti zgjedhor LSI ka denoncuar në Prokurori pretendimin se lista e votuesve në këtë Bashki është shtuar me rreth 500 votues fiktivë që nuk janë banorë të Vorës.

¹⁹ Në KZAZ nr. 8, Bashkia Fushë-Arrëz është raportuar një rast i fotografimit të votës në QV nr. 0392, votë e cila u shpall e pavlefshme; Në KZAZ nr. 19, Bashkia Dibër: në QV nr. 1141/1 u ndërpre votimi në ora 16.40 për fotografim vote dhe rifilloi në ora 17.10 me vendim të KZAZ-së; Në KZAZ nr. 64, Bashkia Berat, procesi i votimit u ndërpre për gjysmë ore në QV nr. 3270 pasi një votuese u kap duke fotografuar fletën e votimit dhe kundërshtonte për ta dorëzuar fletën e votimit pranë KQV-së. Zgjedhësi u pajis me një fletë tjetër votimi dhe fleta e fotografuar u konsiderua e pavlefshme; Në KZAZ nr. 19, Bashkia Diber: në QV nr. 1141/1 u ndërpre votimi në ora 16.40 për fotografim vote dhe rifilloi në ora 17.10.

- Në ZAZ nr. 75, Bashkia Këlcyrë, gjatë procesit të votimit në QV nr. 4220 nga një prej vëzhguesve u evidentua se disa fletë votimi të hedhura në kuti ishin vetëm me një vulë. Pasi u njoftua, KZAZ-ja nisi një nga anëtarët e saj për të verifikuar faktin në vend. U faktua se nga jashtë kutisë shihej se së paku dhjetë fletë votimi ishin të vulosura vetëm me një vulë.

Gjatë procesit të numërimit të votave u përcaktua se numri i këtyre fletëve të votimit ka qenë rreth 30 dhe këto vota u konsideruan të pavlefshme²⁰.

Mbyllja e procesit të votimit dhe dorëzimi i materialeve në KZAZ

Shumica e Qendrave të Votimit në rang vendi u mbyllën në orën 19:00 sipas përcaktimit të Kodit Zgjedhor. Në pak KZAZ është raportuar për QV që e kanë vazhduar procesin e votimit pas orës 19:00 dhe në asnjë rast nuk janë raportuar problematika.

KZAZ-të ngritën nga një deri në tre grupe për marrjen në dorëzim të materialeve të votimit, siç parashikohet në Kod. Shumica e tyre ngritën nga dy të tilla.

Përgjithësisht procesi i dorëzimit të materialeve të votimit është zhvilluar në rregull, me përjashtime të pakta, si në KZAZ nr. 6 ku raportohet se ka qenë i rrëmujshëm.

Në shumicën e KZAZ-ve raportohet se u krijuan radhë të gjata gjatë procesit të marrjes në dorëzim të materialeve.

Ajo çka u vu re edhe në këto zgjedhje është se anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) nuk ishin trajnuar paraprakisht dhe në një pjesë të konsiderueshme të ZAZ-ve kjo ka vonuar nisjen e numërimit të votave, pasi trajnimi është kryer në VNV pas përfundimit të marrjes në dorëzim të materialeve.

Një nga shkaqet është se anëtarët e GNV-ve ndryshohen në momentet e fundit nga partitë politike, në të njëjtën mënyrë si anëtarët e QV-ve, por në rastet e numëruesve ky fenomen është akoma më i theksuar.

Performanca e KZAZ-ve pas ditës së votimit

Numërimi i votave

Numërimi i votave ka qenë sërish i ngadaltë dhe me zvarritje, pushime të gjata e të tjera problematika. Në të gjitha Vendet e Numërimit të Votave (VNV) është raportuar prezenca e militantëve të partive politike në mjediset rrethuese të KZAZ-ve²¹.

Edhe në mjediset VNV-ve është vëzhguar rrëmujë e krijuar si pasojë e vëzhguesve të shumtë, ndërkohë që në shumë raste vëzhguesit e partive politike komunikojnë me anëtarët e grupeve të numërimit të votave, duke e ngadalësuar akoma më shumë procesin e numërimit²².

²⁰ Vlen të përmendet se të gjitha votat ishin për kandidatin e pavarur për Bashkinë Këlcyrë z. Bujar Fezga, i cili pas çregjistrimit të kandidatit Z. Muhameti të APPD-së nga KQZ-ja, mbështetej publikisht nga PD si kandidat i APPD-së.

²¹ Në datë 23 qershor, rreth orës 23:00 jashtë KZAZ-së nr. 1, Bashkia Malësi e Madhe ka patur një përleshje mes mbështetësve të Partisë Socialiste dhe atyre të Partisë Demokratike. Në përleshje ka qenë prezent kryetari i PD-së për Malësinë e Madhe dhe deputeti i PS, Paulin Stërkaj; në KZAZ nr. 27, Bashkia Kamëz janë vërejtur militantë jo vetëm jashtë ambienteve të VNV-së por edhe brenda saj.

²² Në KZAZ nr. 1, Bashkia Malësi e Madhe procesi i numërimit të votave ka qenë shumë i ngadaltë. Numëruesit janë paraqitur me vonesë deri në shtatë orë ditën e parë. Prosesi i numërimit në këtë KZAZ ka ecur shumë ngadalë pasi vëzhguesit vazhdimisht kanë ndërhyrë në proces duke u konfrontuar shpesh

Në disa VNV ka qenë e nevojshme ndërprerja e procesit të numërimit dhe nxjerrja jashtë e vëzhguesve për të rivendosur rregullin; në disa prej rasteve është kërkuar edhe ndërhyrja e forcave të rendit për të zbratur VNV-në²³.

Madje në VNV-në e KZAZ-së nr. 2, Bashkia Shkodër ka ndodhur një grindje brenda VNV-së, pasi një vëzhgues i një partie të vogël gjatë numërimit ka akuzuar numëruesin e LSI-së se nuk i dha rezultatin e partisë së tij²⁴. Gjithashtu janë evidentuar edhe disa incidente të tjera²⁵.

Teknika mbështetëse ka funksionuar pothuajse në të gjitha VNV-të mirë, me përjashtim të pak rasteve ku janë shfaqur problematika²⁶.

Një problem tjetër që u vu re ishte zvarritja e procesit të miratimit të tabelave përmbledhëse dhe i nxjerrjes së rezultateve finale, pas përfundimit të procesit të numërimit. Sidomos, kjo u vu re në të gjitha bashkitë që kishin më shumë se një ZAZ, dhe ku është detyrë e KQZ-së që të përpilojë tabelën përmbledhëse dhe të shpallë rezultatin final.

Ankimime të paraqitura në KZAZ

Disa ankimime kanë mbërritur në KZAZ të ndryshme gjatë kësaj periudhe, si në:

verbalisht me numëruesit. Disa herë KZAZ-ja ka marrë vendim për të nxjerrë vëzhguesit jashtë dhe rifutur ata në KZAZ vetëm pasi të qetësohet situata, por qetësimi ka qenë gjithnjë i përkohshëm. KZAZ i ka ndërruar edhe numëruesit disa herë, pasi ata nuk paraqiteshin në detyrë duke bllokuar procesin. KQZ-ja ka dërguar inspektorët e vet në këtë KZAZ për të lehtësuar procesin; Në KZAZ nr. 67 Bashkia Pogradec, ka patur debate mes vëzhguesve dhe numëruesve, por që nuk u bënë shkak për ndërprerjen e numërimit përveçse në një rast kur KZAZ ka nxjerrë të gjithë vëzhguesit nga VNV-ja dhe i ka rikthyer më vonë ata me listë.

²³ Në KZAZ nr. 23, Bashkia Durrës; Në KZAZ nr. 42, Bashkia Tiranë; Në KZAZ nr. 14, Bashkia Mirditë: gjatë numërimit të votave për anëtarë të këshillit bashkiak, pati 3 raste kur u kërkuar ndërhyrja e forcave të rendit për të vendosur qetësi në VNV; Në KZAZ nr. 42 Bashkia Kavajë: gjatë gjithë kohës ka patur vonesa dhe zvarritje të procesit të numërimit. Disa herë është ndërprerë procesi dhe nxjerrë jashtë vëzhguesit për shkak të rrëmujës së krijuar në KZAZ; Në KZAZ nr. 67 Bashkia Pogradec; Në KZAZ nr. 77 Bashkia Tepelenë, gjatë numërimit të votave, anëtarët e GNV të PD u larguan nga salla, me pretendimin se ishte bërë një manipulim. Pas një ndërprerje të numërimit KZAZ vendosi të vazhdonte numërimin me anëtarët e GNV-ve përfaqësues të PS-LSI-PR.

²⁴ Vëzhguesi kaloi shiritin ndarës që delimiton zonën e vëzhguesve dhe u afrua në tavolinën e numërimit, ndërkohë që numëruesi e goditi. U desh ndërhyrja e KZAZ-së dhe e forcave të rendit për të nxjerrë jashtë. KZAZ bëri një mbledhje urgjente dhe vendosi të ndërprejë numërimin për një orë. Pas kësaj, nga dita e nesërme në këtë KZAZ, u vendosën dy të deleguar të KQZ-së nga Tirana, që po vëzhgojnë deri në përfundim të procesit të numërimit.

²⁵ Si psh. në KZAZ nr. 57, Bashkia Fier, në datën 24.06.2015, rreth orës 02:00 një anëtar i GNV-së u sulmua nga një vëzhgues dhe si pasojë e goditjeve të marra u dërgua në spital. Vëzhguesi që e sulmoi numëruesin ishte një ish anëtar i Këshillit Bashkiak i shoqëruar nga dy djemtë e tij (nuk është e qartë nëse djemtë ishin vëzhgues të akredituar). Gjatë incidentit u shaktuan edhe dëme materiale në VNV. Edhe në KZAZ nr. 19, Bashkia Dibër, ndërkohë që numëroheshin kutitë e fundit për Këshillin Bashkiak pati një debat të fortë mes vëzhguesve të PDIU dhe një numëruesi të LSI-së. Me ndërhyrjen e KZAZ-së dhe me shumë vështirësi situata u qetësua.

²⁶ Në KZAZ nr. 51, Bashkia Gramsh: në datën 23 qershor, gjatë procesit të numërimit teknika nuk funksionoi për rreth 30 minuta; Në KZAZ nr. 52, Bashkia Librazhd: ka patur vështirësi me hedhjen në sistem të rezultateve për dy QV pasi sistemi nuk pranonte rezultatet duke qenë se numri i fletëve të dorëzuara në total ishte më i vogël sesa numri i votave të gjendura në kuti. KZAZ kërkoi ndërhyrjen e KQZ-së dhe ndërkohë që pritej asistencë u ndërpre numërimi për rreth dy orë; Në KZAZ nr. 2, Bashkia Shkodër: pati ikje të energjisë elektrike që zgjati për rreth 10 minuta.

- KZAZ nr. 65, Bashkia Poliçan ku subjekti zgjedhor PD ka ankimuar për pesë vota të cilat ua kishin quajtur të pavlefshme.

Kërkesa për shqyrtimin e votave nuk u aprovua pasi diferenca e votave midis partive ishte e madhe dhe shqyrtimi i tyre nuk do të bënte ndryshim.

- KZAZ nr. 78 Bashkia Gjirokastrë. Partia Fryma e Re Demokratike (FRD) ka bërë një ankimim në datën 24.06.2015, por shkresa e dërguar ishte e paqartë pasi pretendohet se në kutitë e votimit 3 dhe 4 nuk janë numëruar saktë votat e kësaj force politike, por pa specifikuar numrin e QV-së. KZAZ-ja nuk ka marrë vendim pasi mungonte numri i QV-së.

- KZAZ nr. 52 Bashkia Librazhd. Partia Republikane (PR) kërkoi rinumërimin e votave në kutitë e QV-ve me numër: 2704, 2704/1, 2707, 2752 dhe 2741 pasi pretendon se rezultati në këto QV është deformuar. Gjithashtu, Partia e të Drejtave të Mohuara e Re (PDMR) pretendon se votat e kësaj partie i janë kaluar në sistem emrit pasardhës.

- KZAZ nr. 16, Bashkia Mat. Gjatë numërimit, në QV nr. 0924 në kutinë e votave për kandidatin mungonin 2 vota dhe ato u gjetën në kutinë e kandidatëve për Këshill.

Në datën 22.06.2015 u mbajt procesverbal për mungesën e dy votave, në datën 23.06.2015 pasi filloi numërimi për Këshillin Bashkiak në kutinë e QV nr. 0924 u gjetën 2 votat e munguara, të cilat ishin hedhur gabim.

Pas kësaj KZAZ-ja mori vendim të hapet kutia e materialeve për verifikim. Kjo solli tensionim të situatës pasi koalicioni APPD e kundërshtoi. Lidhur me këtë u bë ankim në KZAZ me objekt: “Për kundërshtim të vendimit për hapjen e kutisë së materialeve zgjedhore të QV nr. 0924”, të cilën KZAZ vendosi ta hapte.

- KZAZ nr. 77, Bashkia Tepelenë, ka patur këto ankime:

1. Kandidati i PD-së ka kërkuar rinumërim të votave.
2. Kandidati i pavarur ka kërkuar rinumërim të votave.
3. Kandidati i pavarur ka bërë një ankimim për vendimin e marrë nga ana e KZAZ-së për fletët e votimit që u morrën në 4 QV për të plotësuar numrin e fletëve të votimit për Qendrën e Posaçme të Votimit në burgun e Bençës.

B. INSTITUCIONE TË TJERA TË ANGAZHUARA NË NDËRTIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR

B.1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Listat e zgjedhësve në Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale (IEVP)

Gjendja e listave të votuesve pranë IEVP-ve, është një shqetësim i trajtuar në Raportin pararendës të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, duke e konsideruar atë si një problematikë jo të vogël.

Mungesa e theksuar e transparensës prej institucioneve përgjegjëse, shkelja e kuadrit ligjor si dhe keqadministrimi i këtij procesi, janë tre elementët që evidentohen në shqyrtimin e kësaj çështje.

Sipas deklarimit që Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve z. Artur Zoto bëri në mbledhjen e datës 16.06.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për zgjedhjet e 21 qershorit, nga 5,798 të burgosur që ndodhen pranë IEVP-ve, vetëm 5,168 kishin të drejtë vote. Pjesa tjetër ishin shtetas të huaj dhe minorenë, grup ky i privuar nga e drejta e votës.

Mospërfshirja e personave të burgosur në institucionet penitenciare në listat e zgjedhësve u ngrit zyrtarisht si problematikë prej raportit të auditit teknikien pranë KQZ-së, që më datën 28 Maj 2015. Një problem jo i vogël ky që evidentohet rastësisht gjatë raportimit periodik të një prej auditëve.

Lidhur me këtë çështje Kryetarja e KQZ-së, znj. Lefterije Luzi zhvilloi një takim në datë 04.06.2015 me Ministrin e Drejtësisë, z. Nasip Naço, dhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, z. Artur Zoto.

Më herët, me datë 28.05.2015, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë iu drejtua me një shkresë²⁷ për informim Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në lidhje me situatën e këtyre listave. Me datë 11.06.2015, edhe Ministria e Drejtësisë iu drejtua Drejtorisë së Burgjeve me shkresë kujtuese në lidhje me kërkesën në fjalë.

Vetëm me datë 19.06.2015, jashtë afateve që kërkon ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve komunikoi, me shkresën Numër 5086/2 Prot, informacionin e kërkuar²⁸.

Hapat dhe masat e ndërmarra që përshkruhen në këtë shkresë të lëshuar nga DPGJ, si institucioni përgjegjës, vuajnë nga mosnjohja e administratës sëtij rreth kuadrit ligjor, vonesa dhe tejkalime afatesh ligjorë, të cilat nuk janë as objektivist të justifikueshme.

Në ecurinë institucionale të procesit të treguar në këtë shkresë vihen re këto problematika (citimet janë të shkresës në fjalë):

a) “Me shkresën nr. 3359 Prot, datë 17.04.2015 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i është drejtuar të gjithë institucioneve në varësi për përgatitjen e listave të zgjedhësve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. (...)”

²⁷ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, Shkresa me Nr L0529/1B Prot, datë 28.05.2015, Lënda: “Masat e marra për përfshirjen e personave të dënuar dhe të paraburgosur në listat e zgjedhësve për zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015.”

²⁸ Në fakt kjo shkresë në mnyrë të pakuptimtë është dorëzuar fillimisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili nga ana e tij e ridërgoi dorazi në adresën e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë me datë 25.06.2015.

Periudha që ligji ia kushton periudhës së përgatitjeve të listave të zgjedhësve, fillon 30 ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve dhe shkon deri 40 ditë para datës kur mbahen zgjedhjet²⁹, pra nga data 14 Janar deri më datën 11 Maj 2015.

Sipas kësaj shkrese, vetëm 24 ditë para përfundimit të kësaj periudhe Drejtoria e Burgjeve nisi procesin e përgatitjes së listave të zgjedhësve për personat që vuajnë heqjen e lirisë. Kjo vonesë solli problematikat e veta që u panë në vijimësi.

b) *“Me shkresën nr. 3358 datë 17.04.2015 i jemi drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku i kemi i kërkuar udhëzime se si do të veprohet me ata të dënuar dhe të paraburgosur që nuk janë banorë në njësinë zgjedhore ku ndodhet institucioni, të cilët plotësojnë kriteret ligjore dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në votime. (...)”*

Jo vetëm që procesi nisët me vonesë dhe ka padijeni institucionale të kuadrit ligjor, por edhe vetë kërkesa për informim është akoma më e vonuar.

Kjo u pohua edhe prej vetë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve z. Zoto në seancën e mbledhjes së KQZ-së me datë 16.06.2015. Argumentimi që ai dha ishte se Vendimi i Këshillit të Ministrave që rregullonte çështjen në fjalë ishte e hershëm dhe për këtë shkak ata nuk ishin në dijeni.

c) *“Me shkresën nr 4996/1 datë 01.06.2015, janë udhëzuar institucionet e varësisë që në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor neni 57 “Vendimet Gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve”, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, t’i drejtohen gjykatave të rretheve gjyqësore për përfshirjen e personave me liri të kufizuar të paregjistruar në qendrën e votimit të posaçëm, në zyrën përkatëse të gjendjes civile. (...)”*

Zgjidhja që u dha edhe prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili pasqyrohet edhe në shkresë, ka për bazë nenin 57 të Kodit Zgjedhor³⁰.

Kjo zgjidhje u dha pasi pas datës 11 maj 2015, ligjërisht dhe teknikisht është e pamundur ndërhyrja në listat e zgjedhësve.

²⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012):

Neni 51, *“Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë”* dhe Neni 56 *“Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve”*.

³⁰ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 57 *“Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve”* pika: *“1. Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësive së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore.”*

2. Në rast se zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit ku ka emrin në listën e miratuar. Në rast se zgjedhësi paraqet kërkesë në gjykatë në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë dhe vendosin në lidhje me kërkesat, sipas pikës 1 të këtij neni, si në ditën e fundit para zgjedhjeve, edhe në ditën e zgjedhjeve, por jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit. Në rastin kur vendimi gjyqësor bën korrigjimin e përbërësve zgjedhorë, përcaktohet qartë përbërësi zgjedhor që ndryshohet. Kur saktësohet qendra e votimit ose zgjedhësi shtohet në listë, vendimi gjyqësor përcakton qendrën e votimit ku zgjedhësi do të votojë dhe numrin e dokumentit të identifikimit.

4. Emri i zgjedhësit që paraqitet për të votuar me vendim gjykate shënohet nga KQV-ja në një regjistër të posaçëm, të cilit i bashkëngjitet vendimi i gjykatës. Në këtë regjistër shënohet edhe numri i dokumentit të identifikimit që përdoret për votim. E njëjta procedurë zbatohet edhe për rastet kur vendimi është marrë në përputhje me nenin 55, por vendimi nuk është pasqyruar në listën e zgjedhësve.”

Megjithatë, duke u bazuar në parashikimin e bërë nga ky nen i Kodit Zgjedhor, konstatohet se kjo zgjidhje ka bazë të shtrembëruar ligjore.

Tri rastet që i referohet Kodi Zgjedhor si mundësi për “korrektim” të listave të zgjedhësve me vendim gjykate pas afatit ligjor janë atëhere kur:

- zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi;
- zgjedhësi vëren se nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij;
- zgjedhësi vëren se nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njesisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin.

Problematika në rastin e zgjedhësve që vuajnë heqjen e lirisë nuk përbën asnjë prej rasteve për të cilat Kodi Zgjedhor mundëson votimin me vendim gjykate. Zgjidhja ligjore që u përdor, nga institucionet e Gjendjes Civile dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si bazë në këtë rast është tërësisht e gabuar.

d) Si edhe në shkresat e mëparshme shihet në vazhdim një vonesë dhe ecuri e ngadaltë në punën e këtij institucioni për zgjidhjen e çështjes për të cilën është bashkëfajtor.

“Me shkresën nr. 5385 datë 09.06.2015 është informuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me masat e marra dhe disa prej problematikave të konstatuara në hapjen e qendrave të posaçme të votimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. (...)”

Ngadalësia në punën e institucionit vazhdon. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve informohet vetëm 10 ditë para ditës së zgjedhjeve në lidhje me qendrat e posaçme të votimit.

Nga ana tjetër, edhe vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u vu në lëvizje dhe veproi me vonesë mbi këtë problematikë në datën 20.06.2015 me Vendimin numër 719 dhe me datë 21.06.2015 me Vendimin numër 723³¹.

Vetëm disa orë përpara nisjes së procesit të votimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi për ngritjen e dy Qendrave të Posaçme Votimi të reja, në dy institucionet penitenciare Peqin dhe Rrogozhinë.

Megjithëse në dijeni se në QV e posaçme të ngritura pranë IEVP-ve numri i fletëve të votimit të parashikuara për votuesit e regjistruar në lista, ishin të pamjaftueshme për shkak të shtimit të votuesve të rinj me vendim gjykate, KQZ, akoma edhe më vonë morri në shqyrtim këtë çështje.

KQZ-ja rreth orës 00.30 të datës 21.06.2015 vendosi që 17 KZAZ-të, që mbulonin këto QV të posaçme, të ngarkoheshin që sipas diskrecionit të tyre të siguronin prej KQV-ve në administrim sasi të nevojshme të fletëve të votimit për t’ia shpërndarë 17 QV-të ku u “shtuan” votuesit e papërfshirë³² me vendim gjykate.

³¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 719, datë 20.06.2016, “Për miratimin e dhënies autorizim për ngritjen e dy qendrave të votimit të posaçme në bashkinë Peqin dhe Rrogozhinë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015.”

Vendimi nr. 723, datë 21.06.2016, “Për sigurimin e fletëve të votimit shtesë për disa qendra votimi të posaçme”

³² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 723, datë 21.06.2016, “Për sigurimin e fletëve të votimit shtesë për disa qendra votimi të posaçme”. Sipas tij autorizohen KZAZ-të me nr. 64, 16, 22, 20, 44, 45, 77, 71, 11, 13, 31, 39, 29, 43, 83 dhe 88.

C. HESHTJA ZGJEDHORE DHE MEDIA

Thyerja e periudhës së heshtjes zgjedhore

Fushata zgjedhore u mbyll zyrtarisht ditën e premte me datë 19 qershor duke qenë se dita përpara zgjedhjeve dhe dita e zgjedhjeve, deri në mbylljen e procesit të votimit, në orën 19:00 përbën periudhën e heshtjes zgjedhore³³.

Megjithatë, periudha e heshtjes zgjedhore është shkelur jo vetëm në ditën e shtunë datë 20 qershor, ditën përpara ditës së zgjedhjeve, por edhe në ditën e zgjedhjeve.

Subjektet zgjedhore Partia Socialiste (PS), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Demokratike (PD) e kanë thyer heshtjen zgjedhore ditën e zgjedhjeve.

Në disa konferenca për shtyp³⁴ të dhëna nga selitë zyrtare të këtyre partive deputetet Olta Xhaçka e Jorida Tabaku, si dhe drejtueset e Lëvizjeve Rinore të PS-së dhe LSI-së, respektivisht Maria Myridinas dhe Erisa Xhixho u kanë bërë thirrje qytetarëve për të votuar³⁵.

Pavarësisht se mesazhi i komunikuar verbalisht nuk ka përmbajtur propagandë elektorale, sfondi në të cilin të gjitha Konferencat për Shtyp janë kryer, pa patur në përmbajtje të tij sloganet elektorale të partive respektive politike, duke përbërë shkelje të heshtjes zgjedhore pasi qartazi sloganet elektorale të partive politike përbëjnë mesazh elektorale dhe është pjesë përbërëse e fushatës elektorale.

I njëjti fenomen u vu re edhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Bashkisë Kamëz, ku përveçse konsiderohet thyerje e heshtjes zgjedhore, kategorizohet edhe si përdorim i hapur i burimeve të administratës shtetërore³⁶, në kundërshtim me sa detyron Kodi Zgjedhor.

³³ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012). Neni 77 “*Periudha e fushatës dhe heshtjes zgjedhore*”, pika 2 “*Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.*” <http://www2.cec.org.al/sq-al/kodi-zgjedhor>.

³⁴ PS ka dhënë pesë konferenca, LSI dy konferenca dhe PD një konferencë.

³⁵ <http://shqiptarja.com/Zgjedhjet%20Vendore%202015/2760/deputetet-apel-p-r-pjesmarrje-n-votim-gra-e-vajza-votoni-masivisht---300461.html>.

³⁶ Kandidati i Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD) për Bashkinë Kamëz, Xhelal Mziu, njëkohësisht Kryetar i kësaj Bashkie aktualisht, e ka thyer gjithashtu heshtjen zgjedhore në datën 20 Qershor 2015 nëpërmjet një lajmi në faqen zyrtare të Bashkisë për nisjen e një projekti për ujësjellës-kanalizimet.

Duke patur në konsideratë që pika 2.b e Nenit 84 të Kodit Zgjedhor konsideron veprimtari që ndjek qëllime elektorale çdo veprimtari e cila “...synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike”, ky njoftim i kryer në ditën e heshtjes zgjedhore përbën qartas një shkelje të saj. Për më tepër, në një prej fotove që shoqërojnë lajmin ku është pasqyruar tabela që jep detajet e projektit, pas tabelës në fjalë është një banner elektorale i kandidatit Mziu i cili në fakt zë pjesën më të madhe të fotos (Bashkia Kamëz. *Nis zbatimin projekti madhor i ujësjellës-kanalizimeve*. Njoftim postuar më datë 20 qershor 2015 në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz. <http://www.kamza.gov.al>). Përveçse thyerje e heshtjes zgjedhore, ky rast përbën edhe një shfrytëzim të burimeve publike (faqes zyrtare të Bashkisë Kamëz) për fushatën elektorale të kandidatit Mziu, ndërkohë që edhe gazeta zyrtare e Bashkisë është përdorur hapur gjatë gjithë periudhës së fushatës në favor të këtij kandidati..

Media

Mediat i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë ditës së fundit të fushatës zgjedhore, ditës së zgjedhjeve dhe procesit të numërimit, ku disa prej tyre kanë synuar edhe në nxjerrjen e rezultateve në kohë reale për publikun.

KVV vlerëson lart rolin e mediave përgjatë këtyre hapave të fundit të procesit zgjedhor në informimin e publikut, pasjen në vëmendje të veçantë të çdo sinjali për incidente apo problematika që mund të shoqëronin procesin dhe gjykon se ky rol është i pazvëndësueshëm në rritjen e transparencës dhe të informimit të publikut.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, ka patur sinjale për tentativa të ndalimit të gazetarëve që të kryejnë detyrën e tyre, si p.sh. në Bashkinë Vorë, ekipi i gazetarëve të Ora Neës është kërcënuar të mos filmojë prej personave jashtë qendrave të votimit sipas gazetares Denisa Pasholli të këtij televizioni.

Në vazhden e gjithë kohëzgjatjes së fushatës, edhe gjatë ditës së fundit të saj në datën 19 qershor, mediat kanë vazhduar të transmetojnë materialet e ofruara të gatshme nga shtabet elektorale të subjekteve elektorale pa i kaluar ato në filtra dhe duke dështuar të vendosin logon e subjektit që i ofronte, pavarësisht Vendimit nr. 503 të KQZ-së, të datës 3 qershor 2013, ende në fuqi, që i detyron ato t'i vendosin këto logo³⁷.

Mediat në vend e kanë respektuar heshtjen zgjedhore, sipas Raportit Përfundimtar të Bordit të Monitorimit të Medias (BMM), përveç televizionit “TV Skampa” në Elbasan, i cili ka qenë i vetmi operator mediatik i propozuar për penalizim me gjobë për shkelje të heshtjes zgjedhore gjatë kësaj fushate³⁸.

Në fakt, një pjesë e konsiderueshme e mediave kanë transmetuar imazhet filmike të konferencave për shtyp në të cilat përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore PS, LSI dhe PD kanë bërë thirrje për të votuar me sloganet elektorale përkatëse në sfond (ref. Thyerja e heshtjes zgjedhore, më sipër).

Media ka pjesën e vet të përgjegjësisë për shfaqjen e këtyre pamjeve filmike të cilat potencialisht mund të ndikojnë në orientimin dhe zgjedhjen e votueseve.

Ndërkohë nga vëzhgimi i bërë mbi raportet e përgatitura nga BMM-ja, mund të thuhet se evidentohet paqartësi në metodologjinë e përdorur për monitorimin³⁹ e kryer si dhe mbi kriteret e përdorur për të gjykuar mbi balancimin e minutazhit midis forcave politike.

³⁷ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Vendim Nr. 503, datë 03.06.2013, pika: “a. Informacionet mbi aktivitetet e fushatës zgjedhore, që përgatiten dhe transmetohen në edicionet informative bazuar në materiale të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore, duhet të identifikohen qartë; b. Logoja e partisë politike apo koalicionit zgjedhor, duhet të jetë e dukshme, jo më e vogël se logoja e operatorit audioviziv që e transmeton dhe të qëndrojë në ekran jo më pak se një e treta e kohës së transmetimit të materialit, spotit apo reklamës zgjedhore.” <http://www.cec.org.al/sq-al/Vendimet2013>.

³⁸ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Raportet e Bordit të Monitorimit të Medias. Raporti i Bordit të Monitorimit 22.05.2015-19.06.2015. <http://www.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Raportet-e-Bordit-t%C3%AB-Monitorimit-t%C3%AB-Mediave>.

³⁹ Sipas pikës 3 të Nenit 81 të Kodit Zgjedhor, “Transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike, qendrore ose vendore, llogaritet në kohën e transmetimit të subjektit zgjedhor, të cilit i përket titullari i institucionit, nëse veprimtaria ndjek qëllime elektorale”.

Në raportet e BMM-së vërehet se koha e vënë në dispozicion nga mediat e ndryshme për Kryeministrin dhe Qeverinë është e përllogaritur në çdo rast veçmas nga koha e Aleancës për Shqipërinë Europiane (ASHE), pavarësisht se të gjithë anëtarët e kabinetit qeveritar janë prej këtij Koalicioni.

Në raportin përfundimtar, ku dhe është propozuar e vetmja masë me gjobë e aprovuar nga KQZ-ja, nuk qartësohet kriteri i përdorur për të gjykuar se sa duhet të ishte disbalanca në minutazh që BMM-ja të merrte vendim se një media e ka thyer balancën dhe, si rrjedhim, të propozonte masë administrative me gjobë për median përkatëse.

Bazuar në minutazhin e raportuar në raportin që mbulon periudhën nga data 22 maj deri në 21 qershor⁴⁰, ka disbalanca mes dy Koalicioneve kryesore pothuajse në të gjitha mediat, dhe gjithashtu ka disbalancë mes minutazhit të vënë në dispozicion të LSI-së dhe partive të tjera parlamentare që kanë deri në 20% të vendeve në Kuvend⁴¹, ndërkohë që Kodi Zgjedhor parashikon që për këto parti të jepet kohë e barabartë.

D. PJESËMARRJA E GRAVE DHE E MINORITETEVE

Pjesëmarrja e grave

Për herë të parë në këto zgjedhje Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vendosi që përqindja e votimit të grave do të komunikohet së bashku me përqindjen e votuesve në total në përfundim të votimit⁴².

Bazuar në të dhënat nga qendrat e votimit që kanë raportuar ato⁴³, pjesëmarrja e grave në votime ka qenë rreth 44% ndërkohë që përqindja totale në votime është rreth 48%⁴⁴.

Pjesëmarrja e grave në votime është pra më e ulët sesa pjesëmarrja e burrave, pavarësisht se diferenca nuk është shumë e madhe. Sidoqoftë, në frymën e ndryshimeve ligjore dhe politikave në përgjithësi që synojnë një rritje të përfshirjes së grave në vendimmarrje, shifra tregon se ka akoma punë për të bërë në këtë drejtim.

Fushata zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2015 ka treguar një përmirësim në lidhje me pjesëmarrjen e grave në tubime elektorale, ndërkohë që ndryshimet në Kodin Zgjedhor në lidhje me kuotat gjinore për këshillat bashkiakë janë një hap i qenësishëm përpara në rritjen e barazisë gjinore.

Nga raportet nuk sqarohet nëse ky minutazh i përlogaritur veçmas për qeverinë është aktivitet që nuk ka patur ngjyrimë elektorale, dhe ato aktivitete që kanë patur të tilla janë përfshirë në kohën e ASHE-së, apo nëse BMM-ja nuk e ka kontrolluar përmbajtjen e minutave të transmetuara dhe ka konsideruar si aktivitet të Qeverisë apo Kryeministrit çdo aktivitet ku këta të fundit kanë qenë prezentë, nëse nuk kanë qenë të shoqëruar me kandidatë.

⁴⁰ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Raportet e Bordit të Monitorimit të Medias. *Raporti i Bordit të Monitorimit* 22.05.2015-19.06.2015. <http://www.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Raportet-e-Bordit-t%C3%AB-Monitorimit-t%C3%AB-Mediave>.

⁴¹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012). Neni 81, pika 1: “Në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend”. <http://www2.cec.org.al/sq-al/kodi-zgjedhor>.

⁴² Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Vendim Nr. 13, datë 27.01.2015, <http://www2.cec.org.al/sq-al/Legjislacioni/Aktet-e-KOZ-s%C3%AB/Vendimet/Vendimet-2015>

⁴³ Jo të gjitha qendrat e votimit e kanë respektuar Vendimin Nr. 13 që i detyron të dërgojnë të dhëna në KZAZ-të përkatëse për numrin e votuesve.

⁴⁴ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. *Njoftim për Shtyp* 25.06.2015. <http://www.cec.org.al/sq-al/Kreu/ID/378/Njoftim-per-shtyp-25062015>.

Megjithatë, e rëndësishme është të theksohet se aty ku kuadri ligjor mungon, si në rastin e kandidatëve për kryetarë bashkie, barazia gjinore është shumë e ulët.

Vetëm 16 gra kandiduan për postin e kryetarit të bashkisë në të gjithë vendin, nga 158 kandidatë në total, pra vetëm 10.1%, nëntë prej të cilave dolën fituese⁴⁵.

Edhe pasqyrimi i grave në media ka qenë i ulët, nga raporti i BMM-së për periudhën 22 maj – 21 qershor konstatohet se “koha e shpërndarë mes meshkujve dhe femrave është 287 minuta më tepër meshkujt⁴⁶”

Pjesëmarrja e minoriteteve

Me ndarjen e re administrativo-territoriale, tri prej 61 bashkive të reja, ajo e Pustecit, e Finiqit dhe e Dropullit përbëhen në shumicë prej minoriteteve kombëtare, e para prej atij maqedonas dhe dy të tjerat prej atij grek.

Një shqetësim i ngritur prej KVV-së gjatë deklaratave për shtyp të ditës së zgjedhjeve e më parë ka qenë mungesa e trajnimit të komisionerëve të qendrave të votimit dhe të KZAZ-ve. Kjo ka qenë veçanërisht shqetësuese në KZAZ-në nr. 80, Bashkia Dropull ku, si pasojë edhe e ndryshimeve të shpeshta asnjë komisioner QV-je nuk ishte trajnuar.

Për më tepër, tri anëtarët e propozuar nga Partia Socialiste në këtë KZAZ janë ndryshuar⁴⁷ me një vendim të KQZ-së të orës 20:00 të dt. 20 qershor, vetëm 11 orë përpara nisjes së votimit⁴⁸, pas një kërkesë të subjektit që i kishte propozuar.

Ndryshimi i tyre dhe mungesa e trajnimit për anëtarët zëvendësues solli që gjatë ditës së zgjedhjeve dy prej tre komisionerëve të liruar të ishin prezentë herë pas here në KZAZ në mënyrë që të asistonin komisionerët e emëruar një natë më parë, ndërkohë që nuk kishin tagër për të qenë aty.

Një tjetër shqetësim, i sjellë në vëmendje të vëzhguesve të KVV-së gjatë procesit të numërimit vjen prej një prej kandidatëve të Partisë Aleanca Maqedonase për Integrim European (AMIE), i cili kandidonte për këshillin e Bashkisë Korçë. Sipas tij ishte shqetësues fakti i mospasjes së vëzhguesve nga partitë e tyre përgjatë procesit të numërimit, gjatë të cilit kishin marrë indicie se kishte patur mosvlerësim të drejtë të votave të tyre dhe përllogaritje të tyre në favor të subjekteve të tjera elektorale.

Po sipas këtyre informacioneve, bëhen të ditura forma të blerjes së votave në Komunitetet Rome dhe Egjiptiane, madje disa prej këtyre fakteve iu janë bërë të ditura edhe vëzhguesve të OSBE / ODIHR-it në këtë qark.

⁴⁵ Bashkia Gramsh – fituese znj. Luljeta Dollani; Bashkia Ura Vajgurore – fituese znj. Juliana Memia; Bashkia Roskovec – fituese znj. Majlinda Bufi; Bashkia Libohovë – fituese znj. Luiza Mandi; Bashkia Patos – fituese znj. Rajmonda Balilaj; Bashkia Gjirokastër – fituese znj. Zamira Rami; Bashkia Prrenjas – fituese znj. Miranda Rira; Bashkia Sarandë – fituese znj. Florjana Koka; Bashkia Shkodër – fituese znj. Voltana Ademi.

⁴⁶ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Raportet e Bordit të Monitorimit të Medias. Raporti i Bordit të Monitorimit 22.05.2015-19.06.2015. <http://www.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Raportet-e-Bordit-t%C3%AB-Monitorimit-t%C3%AB-Mediave>.

⁴⁷ Anëtarët e liruar nga detyra të kësaj KZAZ-je ishin banorë të Bashkisë Gjirokastër dhe jo të Bashkisë Dropull dhe për këtë arsye janë liruar nga detyra.

⁴⁸ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Vendim Nr. 718, datë 20.06.2015, <http://www2.cec.org.al/sq-al/Legjislacioni/Aktet-e-KQZ-s%C3%AB/Vendimet/Vendimet-2015>.

E. E DREJTA PËR INFORMIM DHE VËZHGUESIT

E drejta e vëzhguesve të pavarur për të ndjekur procesin zgjedhor parashikohet në Nenin 7 të Kodit Zgjedhor.

Bazuar në këtë ligj dhe në frymën e të drejtës për informim dhe të transparencës së aktivitetit të institucioneve publike, vëzhguesit kanë të drejtë “të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor⁴⁹”.

Zgjedhjet për Pushtetin Vendor të 21 Qershorit 2015 u ndoqën nga një numër i ulët vëzhguesish, më pak se gjysma e numrit vëzhguesve që ndoqën Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2013.

Edhe në periudhën e mbuluar në këtë raport, kanë vazhduar problematikat me moszbardhjen e vendimeve⁵⁰ të marra në faqen zyrtare të KQZ-së si dhe me mos hedhjen e materialeve paraprake të mbledhjeve në faqen zyrtare të internetit.

Këto materiale paraprake vazhduan t’u jepen në fillim të mbledhjeve të KQZ-së vetëm përfaqësuesve të forcave politike dhe vëzhguesve të OSBE-së, duke ndikuar jo pak në efektivitetin e vëzhgimit⁵¹ nga vëzhguesit e tjerë, e veçanërisht të KVV-së si vëzhguesi vendor i vetëm që po monitoron në mënyrë të pandërprerë mbledhjet e KQZ-së.

Ky monitorim është vështirësuar edhe si pasojë e mosnjoftimit në kohë apo edhe fare në disa raste për zhvillimin e mbledhjeve të KQZ-së, gjatë kësaj periudhe.

Ndërkohë lidhur me vëzhgimin e procesit në nivelin e dytë të administrimit në 90 ZAZ, raportohet se përgjithësisht nuk janë hasur pengesa gjatë periudhës përgatitore të procesit apo gjatë ditës së votimit në KZAZ-të përkatëse me përjashtim të dy rasteve⁵².

Puna e këtyre KZAZ-ve është ndjekur në mënyrë sporadike veçanërisht tre javët e fundit nga disa vëzhgues vendas si dhe të OSBE/ODIHR.

Megjithatë, sërish në këto zgjedhje u shfaq një problematikë tanimë e njohur për KVV-së që ndodh prej shumë procesesh zgjedhore. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të

⁴⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012). Neni 7, pika 1.a. <http://www2.cec.org.al/sq-al/kodi-zgjedhor>.

⁵⁰ Prej datës 19 – 24 qershor, KQZ-ja ka marrë 51 vendime (vendimet me nr. 690 – nr. 740). Katër prej këtyre vendimeve përkatësisht ai me nr. 728, nr. 736, nr. 737 dhe nr. 738 nuk janë hedhur ende në faqen zyrtare të KQZ-së deri më datën e publikimit të kërrij raporti (29 qershor).

Gjithashtu nuk janë hedhur edhe vendimet e datave 25 dhe 26 qershor, pavarësisht se ka kaluar afati zyrtar prej 24 orësh në brenda të cilit vendimi duhet të zbardhet dhe publikohet në faqen e internetit, sipas pikës 5 të Nenit 23 të Kodit Zgjedhor.

⁵¹ Për më tepër mbi këtë çështje mund t’i referoheni Raportit III të Monitorimit të KVV mbi Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 21 Qershorit 2015, Seksioni E: “E drejta për informim dhe vëzhguesit”, fq. 36. <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-III-ZgjedhjeLokale2015-19Qershor2015.pdf>.

⁵² Në KZAZ-në Nr. 2, Bashkia Shkodër, ditën e votimit, anëtarët e KZAZ-së kanë nxjerrë jashtë të gjithë vëzhguesit me pretendimin se janë të lodhur dhe prezenca e vëzhguesve i pengon të punojnë. Vëzhguesit nuk janë lejuar të rikthehen në KZAZ deri rreth orës 17:00. Ndërsa në KZAZ-në Nr. 70, Bashkia Devoll, anëtarët e KZAZ-së kanë qenë rezistentë dhe në ndarjen e informacionit me vëzhguesin e KVV-së.

materialeve zgjedhore nga QV-të prej KZAZ-ve, vëzhguesit nxirren jashtë nga KZAZ-ja apo nuk lejohen që të hyjnë aty⁵³.

Në disa prej rasteve, jo vetëm vëzhguesit vendorë, por edhe vëzhguesit ndërkombëtarë janë nxjerrë jashtë, ndërkohë që në të tjera raste vetëm vëzhguesit ndërkombëtarë janë lejuar të vëzhgojnë.

Këtij shqetësimi nuk i ka dhënë zgjidhje as KQZ-ja pas komunikimit që i kanë bërë përfaqësuesit e KVV-së titullarëve të saj.

Kjo praktikë e anëtarëve të KZAZ-ve apo e oficerëve të policisë të ngarkuar me ruajtjen e VNV-së⁵⁴ është totalisht në kundërshtim me pikën 1 të Nenit 7 të Kodit Zgjedhor, ku qartas thuhet se e drejta e vëzhguesve shtrihet në të gjithë aspektet e procesit zgjedhor, pa përjashtime.

Ndërkohë vazhdon të mbetet problem vendosja e Komisionit të ZAZ në largësi prej vendqëndrimit të vëzhguesve gjatë procesit të numërimit.

Kjo pasi në rastin e vëzhguesve të KVV-së të cilët kishin marrë përsipër për të vëzhguar në mënyrë sporadike vetëm procedurat, sjelljen dhe mënyrat e veprimtimit të Komisioneve të ZAZ-ve edhe përgjatë procesit të numërimit, ky vëzhgim nuk ishte aspak i lehtë, pasi shpesh konsistonte vetëm në raportimin e asaj çfarë deklarohej nga ndonjë prej anëtarëve të KZAZ-ve, dhe jo në vëzhgimin e drejtëpërdrejtë dhe të sigurimit të kontaktit viziv me procedurat, hartimin e akteve, dokumentimin e vendimmarrjes së marrë, etj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vuri në mënyrë të suksesshme në funksionim, sistemin e raportimit të rezultateve paraprake, të cilat u bënë baza e informimit për të gjitha mediat dhe publikun duke informuar zyrtarisht mbi këto rezultate paraprake, pavarësisht disa gabimeve teknike që u vunë re, të cilat erdhën kryesisht si pasojë e mos informimit të saktë mbi mënyrën e hedhjes së të dhënave nëpër vendet e numërimit të votave.

⁵³ Si në: KZAZ-të Nr. 3 dhe Nr. 4, Bashkia Shkodër; KZAZ Nr. 26, Bashkia Vorë; KZAZ Nr. 27, Bashkia Kamëz; KZAZ-të Nr. 29, Nr. 32, Nr. 36 dhe Nr. 38, Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 42, Bashkia Kavajë dhe KZAZ Nr. 43, Bashkia Rrogozhinë.

⁵⁴ Oficerët e policisë të ngarkuar me ruajtjen e VNV-së janë treguar rezistentë ndaj kërkesave të vëzhguesve me pretendimin se kanë urdhër nga KZAZ-ja të mos lejojnë asnjë të hyjë. Pavarësisht se ata janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e KZAZ-së, në momentin kur një vëzhgues u paraqet akreditimin kanë detyrimin ligjor të thërresin anëtarët e KZAZ-së dhe t'i njohin me rastin dhe jo të mbajnë një rol pasiv e të ngurtë, siç shpesh ndodh, duke i komunikuar vëzhguesit se kanë urdhër dhe duke u bërë ata pengesë për komunikimin midis vëzhguesve dhe anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore.

F. ANKIMIME DHE APELIME

Kodi Zgjedhor në pjesën e dhjetë, nga neni 124 deri në 144, rregullon specifikisht të drejtën e ankimimit në procesin zgjedhor.

Përgjatë periudhës së vëzhgimit që i referohet ky raport, subjektet zgjedhore janë investuar me ankimime në të treja nivelet e ankimimit që parashikon Kodi Zgjedhor: Kolegji Zgjedhor (KZ), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ).

Kolegji Zgjedhor

I vetmi ankimim për të cilin ka marrë vendim në këtë periudhë Kolegji Zgjedhor, ka qenë ai i paraqitur prej Partisë Demokratike (PD). Ky subjekt pretendonte se KQZ-ja nuk ishte shprehur për kërkesën e tij në lidhje me listat e votuesve në Bashkinë e Durrësit.

Partia Demokratike me datë 16.06.2015 me shkresën Nr 6133 Prot, i kërkonte Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si vijon:

“Të marrë të gjitha masat e nevojshme, duke urdhëruar Drejtorinë e Gjendjes Civile, të prodhojë dhe shpërndajë në KZAZ-të përkatëse, lista zgjedhore në të cilat të mos figurojnë të dhënat e shtetasve, rekordet e të cilëve Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë i ka sekuestruar.”

Me datë 19.06.2015, Partia Demokratike me pretendimin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk kishte marrë vendim për kërkesën e saj, iu drejtua Kolegjit Zgjedhor. Objekti i kërkesës ishte:

- “1. Kundërshtim ndaj mosmarrjes vendim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me kërkesën numër 6133, datë 16.06.2015, të Partisë Demokratike të Shqipërisë.*
- 2. Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të marrë vendim lidhur me kërkesën numër 6133, datë 16.06.2015, të Partisë Demokratike të Shqipërisë.”*

Kolegji Zgjedhor me Vendim nr. 21, datë 19.06.2015, pranoi kërkesën e Partisë Demokratike. Ky institucion vendosi për *“detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shprehej me vendim brenda ditës së nesërme, datë 20.06.2015, në lidhje me kërkesën Nr 6133 Prot, datë 16.06.2015, të Partisë Demokratike të Shqipërisë”*.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në seancën e datës 20.06.2015, me Vendimin nr. 710, e rrëzoi kërkesën e Partisë Demokratike për të cilën iu kërkua të merrte vendim, duke argumentuar se: *“nuk ka asnjë dispozitë në Kodin Zgjedhor apo në ligje të tjera t’i caktojnë kompetencën të urdhërojë DPGJC-në të bëj ndryshime duke përjashtuar nga listat e zgjedhësve, zgjedhës të caktuar”*.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Me mbarimin e procesit të numërimit dhe me shpalljen e Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve prej KZAZ-ve (ose KQZ-së), procesi zgjedhor hyn në etapën e ankimimeve dhe apelimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Me datë 26.06.2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbajti tre seanca mbledhjesh, në rendin e ditës të së cilave ishin 8 kërkesa ankimore për vendimet e disa KZAZ-ve.

Pas hedhjes së shorteve për përzgjedhjen e Komisionerëve si Relatorë dhe pas relacioneve të mbajtura prej tyre, u vendos me unanimitet për shqyrtimin e dy ankimimeve me datë 28.06.2015.

Për gjashtë ankimimet e tjera u vendos sërish me unanimitet për kthimin e tyre për plotësim dokumentacioni nga ankimuesit brenda 24 orëve⁵⁵.

Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor

E drejta për t'u ankimuar në Komisionet Zonale të Administrimit, është ushtruar përgjatë kësaj periudhe në disa raste.

Për shkak të mungesës së transparencës së plotë nga KZAZ-të, vëzhguesit kanë arritur të kenë vetëm informacion verbal prej anëtarëve të tyre⁵⁶.

Lidhur me këto ankimime, qëndrimi i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë do bëhet i ditur në Raportin Final.

⁵⁵ Lista e kërkesave ankimore të shqyrtuara janë:

- Kërkesa ankimore nr. 24. Ankimues Partia Bashkimi Liberal Demokrat. KZAZ nr. 17. Relator Hysen Osmanaj. Shqyrtimi me datë 28.05.2015.

- Kërkesa ankimore nr. 25. Ankimues Partia Lëvizja e Legalitetit. KZAZ nr. 17. Relator Gëzim Veleshnja. Shqyrtimi me datë 28.05.2015.

- Kërkesa ankimore nr. 26. Ankimues Partia e Ballit Kombëtar. KZAZ nr. 62. Relator Gëzim Veleshnja. Kthyer për plotësim dokumentacioni.

- Kërkesa ankimore nr. 27. Ankimues Partia e Ballit Kombëtar. KZAZ nr. 54. Relator Klement Zguri. Kthyer për plotësim dokumentacioni.

- Kërkesa ankimore nr. 28. Ankimues Aleanca Demokratike e Shqipërisë. KZAZ nr. 26. Relator Vera Shtjefni. Kthyer për plotësim dokumentacioni.

- Kërkesa ankimore nr. 29. Ankimues Aleanca Demokratike e Shqipërisë. Relator Denar Biba. Kthyer për plotësim dokumentacioni.

- Kërkesa ankimore nr. 30. Relator Lefterije Luzi. Kthyer për plotësim dokumentacioni.

- Kërkesa ankimore nr. 31. Ankimues Aleanca Demokratike e Shqipërisë. KZAZ nr. 31. Relator Hysen Osmanaj. Kthyer për plotësim dokumentacioni.

⁵⁶ Sipas informacionit të marrë nga anëtarët e KZAZ-ve, janë paraqitur këto kërkesa ankimore:

në KZAZ nr. 77 Tepelenë, nga kandidat i pavarur; në KZAZ nr. 52 Librazhd, nga Partia Republikane; në KZAZ nr. 52 Librazhd, nga Partia e të Drejtave të Mohuara e Re; në KZAZ nr. 17 Klos, dy ankimime nga Partia Demokratike; në KZAZ nr. 65 Poliçan, nga Partia Demokratike.

III. AKSIONI I KOALICIONIT TË VËZHguesVE VENDORË

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) është një bashkim vullnetar i 33 organizatave jo qeveritare dhe jo politike thelbi i aktivitetit të cilave është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i demokracisë në vend, e veçanërisht vëzhgimi i proceseve zgjedhor – aktivitet të cilin që prej vitit 2005 e kanë kryer nën siglën KVV.

Strategjia e veprimt të KVV bazohet në tre shtylla: pavarësi, paanësi dhe objektivitet.

Lidhur me ecurinë e procesit zgjedhor të 21 Qershorit 2015 KVV ka publikuar: Raportin e Vlerësimit të Situatës Parazgjedhore (dt. 14.01.2015); Raportin e Parë të Ndërmjetëm të Monitorimit për periudhën 10 Janar - 26 Mars 2015 (dt. 30.03.2015); Raportin e Dytë të Monitorimit për periudhën 27 Mars - 21 Maj 2015 (dt. 04.06.2015); Raportin e Tretë të Monitorimit për periudhën 22 Maj – 18 Qershor 2015 (dt. 19.06.2015), dhe ky është Raporti i Katërt i Ndërmjetëm i Monitorimit që mbulon periudhën prej datës 19 – 26 Qershor 2015, ku përfshihet edhe procesi i Votimit dhe i Numërimit të votave, por i vëzhguar në nivelin e KZAZ-së, se si ajo administroi dhe u soll përgjatë ecurisë së këtyre dy proceseve.

Raporti përfshin gjithashtu gjetjet e dala nga monitorimi i KQZ-së dhe i Kolegjit Zgjedhor, si dhe jep një Konkluzion Paraprak mbi procesin e deritanishëm tashmë kur mbetet vetëm faza e ankimimeve dhe e shpalljes së rezultateve.

IV. FJALORTH

APPD	Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet
ASHE	Aleanca për Shqipërinë Europiane
BMM	Bordi i Monitorimit të Medias
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
FRD	Partia Fryma e Re Demokratike
GNV	Grup i Numërimit të Votave
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PBDNJ	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
PD	Partia Demokratike
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PDMR	Partia e të Drejtave të Mohuara e Re
PR	Partia Republikane
PS	Partia Socialiste
QV	Qendër Votimi
QVP	Qendër Votimi e Posaçme
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZGJC	Zyrat e Gjendjes Civile

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë falënderon:

- Programin e Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së në Tiranë,

- Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe

- Delegacionin e Bashkimit Europian (BE) në Tiranë për mbështetjen financiare të ofruar,

si edhe

- të gjithë aktivistët e të 33 organizatave të Koalicionit për kontributin e tyre vullnetar në realizimin e objektivave të monitorimit përgjatë periudhës që përfshihen në katër Raportet e Ndërmjetme të Monitorimit të publikuara deri tani.

Përmajtja dhe opinionet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e vetme e KVV-së dhe nuk pasqyrojnë në asnjë rast edhe ato të donatorëve!

Kontakt:

i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë

Gerta Meta (Shoqata për Kulturë Demokratike) mob. 0692469393
Rajmonda Prifti (Shoqata për Gratë dhe Fëmijët) mob. 0682152667
Premto Gogo (KRIIK Albania) mob. 0682039297

Contact: Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;
E-mail: info@zqjedhie.al; Website: www.zqjedhie.al;